



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- \* Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
- \* Aktivitete tjera

Dhjetor 2017

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

### Program i specializuar, trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit - sesioni III

Më 01- 02 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e tretë të trajnimit me temën “Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit”.

Ky sesion trajnimi kishte për synim avancimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me luftimin e veprave penale korruptive, kuptimin e korrupsionit sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e korrupsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit.

Në këtë sesion trajnimi u elaboruan

instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftë kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive dhe me një rast nga praktika gjyqësore, ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës dhe zyrtarë të tjerë.



## **Programi trajnues hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit - Pasqyrim i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës të Republikës së Kosovës**

Me 4-8 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, ka zbatuar Programin Trajnues Hyrës nga lëmia e drejtësisë penale për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët janë integruar së fundmi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.



Qëllimi i organizimit të këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kryerjen me sukses të punës në rastet penale.

Në ditën e parë është trajtuar Kodi Penal i Republikës së Kosovës, pjesa e përgjithshme ku janë përfshirë: përgjegjësia penale, dënimet/ndëshkimet dhe konfiskimet si dhe pjesa e veçantë konkretisht kapitujt që përfshijnë veprat penale – elementet objektive dhe subjektive të veprave penale.

Gjatë katër ditëve të tjera, është trajtuar Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, risitë e dispozitave të KPPK-së dhe implementimin e tyre gjatë punës në praktikë.

Në fokus të trajnimit ishin procedura e shkurtër përkatësisht zhvillimi i një procedure standarde, sekuestrimi dhe konfiskimi i sendeve që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale, heqja e paditësit subsidiar si mjet që shfrytëzohet nga ana e të dëmtuarit, nëse prokurori i shtetit tërhiqej nga ndjekja penale, mundësia hetuese e veçantë, kontrolli efektiv i aktakuzës përmes shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë, e që në këtë fazë shqyrtohet edhe mundësia e hudhjes së aktakuzës dhe kundërshtimi i provave.

Më tej vëmendje të veçantë kishin procedurat alternative për zgjidhjen e rasteve në veçanti marrëveshja për pranimin e fajësisë, hetimi sipas KPPK-së si, teknikat e përfaqësimit në gjykim si dhe dëmshtëpërlimi dhe format e kompensimit të viktimave.

Trajnimitin e kanë ndjekur 46 pjesëmarrës, prej tyre gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit të apelit dhe nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës

Me 05 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Procedura gjyqësore për zgjidhjen e martesës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën gjyqësore për zgjidhjen e martesës dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që i referohen kësaj procedure.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me procedurën e zgjidhjes së martesës me anulim dhe procedurën e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit, kompetenca e gjykatës dhe mënyrat e vendosjes si dhe mjetet juridike tek shkurorëzimi.

Në këtë trajnim janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, ku kanë dominuar rastet lidhur me procedurën gjyqësore për zgjidhjen e martesës.

Trajnimi ishte strukturuar në atë mënyrë që i është përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe dilemave që janë paraqitur, duke analizuar gjithanshëm edhe legjislacionin e zbatueshëm që i referohet procedurës gjyqësore për zgjidhjen e martesës.

Në trajnim morën pjesë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore -divizioni civil si dhe bashkëpunëtorë profesional.



## Urdhër kontrolli

Më 6 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve në PTV, ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë “Urdhër kontrolli”.

Qëllimi i trajnimit konsistonte në rëndësinë e avancimit të njohurive rreth zbatimit të urdhër kontrollit, dhe pasojave në rastet e mos zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore në këtë fushë, me fokus në elaborimin e dilemave lidhur me kufizimet gjatë ekzekutimit të urdhër kontrolleve.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaborua çështja e të drejtës së privatësisë dhe respektimit të jetës private gjatë kontrollit, kërkesa për urdhër kontroll dhe përmbajtja e saj, procedura para fillimit të kontrollit, ekzekutimi dhe kufizimet e autoriteteve shtetërore gjatë kontrollit, si dhe rastet e kontrollit pa urdhër të gjykatës.

Paraprakisht u elaboruan provat që nuk kanë lidhshmëri me bazën e kontrollit dhe



pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor si dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.



## Mbledhjen e dëshmime nga Facebook dhe Platforma tjera të Mediave Sociale

Më 7-8 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, në bashkëpunim me EULEX-in ka realizuar trajnimin me temë “Dëshmitë e mbledhura nga facebook dhe platformat tjera të mediave.”



Ky trajnim kishte për qëllim të kontribuoj në avancimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me principet e përgjithshme ligjore dhe çështjet procedurale në lidhje me mbledhjen e dëshmime të pranueshme nga Facebook dhe platformat tjera të mediave sociale online.

Në ditën e parë të këtij trajnimi në mënyrë të hollësishme u elaboruan mediat sociale, çfarë lloji të informatave relevante postojnë në media sociale.

Më tutje u sqarua dallimi i vlerës provuese mes informatave të marra nga Facebook, mediave tjera sociale dhe informatave inteligjente.

Në ditën e dytë të trajnimit u trajtua Etika në lidhje me hetimet e mediave sociale online si implikimet e të drejtave të njeriut, respektimi i të drejtës së privatësisë, si mund të përdoren informatat relevante si dëshmi të pranueshme në procedurë penale, si dhe bashkëpunimi efektiv polici-prokurori për përdorimin e informatave në kohë reale nga postimet në Facebook.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve, ku pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes shembujve praktik të kontribuojnë në tejkalimin e sfidave profesionale që dalin nga kjo fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, si hetues nga Policia e Kosovës.



## Programi trajnues hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit - Etika profesionale dhe Deontologjia

Me 11 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ, në kuadër të Programit Trajnues Hyrës nga lëmia ndërdisiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit, të cilët janë integruar së fundmi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës të ka realizuar trajnimin “Etika Profesionale dhe Deontologjia”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

aplikimin e standardeve të larta personale dhe profesionale.

Në fokus të trajnimit ishin kodi i etikës dhe parimet e përgjithshme të etikës dhe sjelljes profesionale, respektimi i ligjeve të aplikueshme, pavarësia dhe paanshmëria, respektimi standardeve ndërkombëtare, jeta profesionale dhe private e gjyqtarëve edhe prokurorëve, imazhi i sistemit gjyqësor, rregullat specifike të etikës, veprimtaritë gjyqësore dhe jo gjyqësore, rregullat specifike të sjelljes profesionale dhe përgjegjësitë gjykuese.

Trajnimin e kanë ndjekura 47 pjesëmarrës, prej tyre gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit të apelit dhe nivelit themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovës



## Programi Trajnues Hyrës për Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit Programi trajnues i drejtësisë civile

Nga data 12 deri 15 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ, ka zbatuar Programin Trajnues Hyrës nga lëmia e drejtësisë civile, për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët janë integruar së fundmi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.



Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve rreth fushave kryesore të së drejtës civile, siç janë pronësia, detyrimet, procedura kontestimore dhe përmbarimore, marrëdhëniet juridiko-familjare, trashëgimore dhe dhuna në familje.

Theks i veçantë i është dhënë risive të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, llojet e reja të kontratave, si kontrata mbi dhuratën, ortakërinë dhe mbajtjen e përhjetshme, duke vazhduar me dallimin mes normave dispozitive dhe atyre imperative. Në fund u prezantua pavlefshmëria e kontratave, ku u theksuan edhe kontratat nule dhe ato absolutisht nule.

Në kuadër të trajnimit për pronësinë, është trajtuar legjislacioni vendor dhe ndërkombëtarë për të drejtat pronësore dhe të drejtat tjera sendore, struktura institucionale në mbrojtje të pronës, praktika gjyqësore dhe mbrojtja e pronës si një nga të drejtat themelore të njeriut. detyrimeve.

Gjithashtu në kuadër të drejtësisë civile janë trajtuar parimet e procedurës kontestimore siç

janë parimi i kushtetutshmërisë, i ligjshmërisë, parimi i dëgjimit të palëve, parimi i publicitetit, parimi i shqyrtimit dhe hetimit, parimi i gjuhës, shfrytëzimi i të drejtave në procedurën kontestimore dhe mosrespektimi i gjykatës, prezumimet procedurale për zhvillimin e procedurës kontestimore, raporti i procedurës kontestimore me procedurën jokontestimore, ndryshimet e strukturës ligjore lidhur me kompetencën, strategjia për ekzekutimin e lëndëve – sfidat, si dhe çështjet që lidhen me privatizimin si dhe probleme të praktikës gjyqësore nga aspekte tjera të fushës civile.

Në kuadër të marrëdhënieve juridiko-familjare, trashëgimore dhe dhunës në familje janë trajtuar ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, trashëgimia me ligj dhe testament, shqyrtimi i pasurisë trashëgimore, procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, unifikimi i kërkesave për shqiptimin e urdhrit mbrojtës, vlerësimi i kushteve për shqiptimin e masave mbrojtëse adekuate, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të masave të shqiptuara.

Trajnimin e kanë ndjekur gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit të apelit dhe nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.





## Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore

Më 12 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të procedurave specifike tek rastet ku përfshihen kryerës të veprave penale me çrregullime mendore, si dhe në kuptimin e kushteve lidhur me aftësinë e këtyre personave për t’iu nënshtruar gjykimit.

Trajnimi u fokusua në trajtimin e kornizës ligjore vendore, e cila rregullon këtë sferë, kushtet për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm, në veçanti u diskutua trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe trajtimi

i detyrueshëm psikiatrik në liri, si dhe praktika jo e unifikuar në përpilimin e vendimeve për caktim të këtyre masave. Paraprakisht, u shtjellua edhe zbatimi i ekzaminimit psikiatrik nga eksperti, qëllimi i këtij ekzaminimi dhe fazat e dhënies së urdhrimit për ekzaminim psikiatrik me ç’ rast u potencua niveli jo i kënaqshëm i ekspertizave të përgatitura nga ekspertët.

Vëmendje iu kushtua edhe paraburgimit dhe kushteve të veçanta që duhet plotësuar për të përcaktuar paraburgimin ndaj personave me çrregullime mendore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët të nivelit të themelore nga regjionet të ndryshme të Kosovës.



## Anulimi i kontratave

Më 13 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temën “Anulimi i kontratave”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rëndësinë e kontratës si burim i rëndësishëm i detyrimeve, si dhe kushtet ligjore që duhet plotësuar për të konsideruar një kontratë e vlefshme dhe kusht

për tu konsideruar një kontratë nule.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me kontratat nule dhe kontratat e rrzueshme. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave si dhe konversioni.

Në këtë trajnim janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, ku secili nga pjesëmarrësit ka qenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit. Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me pasojat e nulitetit dhe anulimit të kontratave.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore - Departamenti i Përgjithshëm – divizioni civil.



## Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik - sesioni III

Më 15 dhe 16 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e tretë të trajnimit me temën “Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik”.



Ky trajnim kishte për synim avancimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur në zbatimin e hetimeve dhe procedurave që duhet ndjekur për luftimin e krimit kibernetik.

Në fokus të këtij sesioni trajnues ishin bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetikë, institucionet kompetente që merren me këto vepra dhe veprat tjera që lidhen me krimin kibernetik, mundësitë e ndjekjes së suksesshme të e-krimin ndërkombëtar dhe krimit kibernetik.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive, dhe me trajtimin e rasteve praktike, ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre. Po ashtu në këtë trajnim u përdorën metodat e krahasimit të legjislacionit vendor me atë ndërkombëtarë që e sanksionojnë krimin kibernetik si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në luftimin e kësaj dukurie.

Përfitues të këtij trajnimi kanë qenë gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Programi trajnues hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit - Menaxhimi i gjykatës/prokurorisë dhe menaxhimi i rasteve

Me 18 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ, në kuadër të Programit Trajnues Hyrës nga fusha ndërdisiplinore, për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët janë integruar së fundmi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, ka realizuar trajnimin “Menaxhimi i gjykatës/prokurorisë dhe menaxhimi i rasteve”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth organizimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe procesit të menaxhimit të drejtë të rasteve në institucionet e drejtësisë.

Në fillim të trajnimit është prezantuar struktura dhe organizimi i gjykatave në Kosovë dhe roli i tyre në dhënien e drejtësisë, mënyrat e

administrimit të tyre nga ana e KGJK-së.

Në pjesën e menaxhimit të rasteve në gjykatë është diskutuar edhe strategjia kombëtare për reduktimin e rasteve të grumbulluara si dhe u elaburuan metodat më të mira për ti aplikuar me rastin e trajtimit të lëndëve.

Në pjesën e pasdites u prezantua struktura, organizimi dhe administrimi i sistemit prokurorial, përgjegjësitë, përbërja, dhe mandati i KPK-së, prokuroritë dhe përgjegjësitë e tyre, Prokuroria Speciale dhe rastet që i vihen në barrë sipas mandatit. Po ashtu u prezantua edhe puna e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike, ku pjesëmarrësit kanë qenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, duke diskutuar rreth çështjeve të menaxhimit të gjykatave dhe prokurorive dhe menaxhimit të rasteve.

Trajnimin e kanë ndjekura 35 pjesëmarrës, prej tyre gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit të apelit dhe nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Mjetet e rregullta dhe bazat e ankesës

Më 19 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Mjetet e rregullta dhe bazat e ankesës”.



Trajnimi kishte për synim avancimin e njohurive lidhur me përdorimin e mjeteve të rregullta dhe bazat kur mund të paraqitet ankesa, paanshmëria në shqyrtimin e mjetit juridik, palët në procedurën përkitazi me mjetet

e rregullta juridike, shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, etj.

Në fokus të trajnimit ishin ankesa si mjet i rregullt, devolutiv dhe suspensiv, elementet përmbajtësore të ankesës, bazat për ushtrimin e mjeteve juridike, rregullat e përgjithshme lidhur me mjetet juridike, ankesa ndaj aktgjyqimit dhe aktvendimit, dhe bazat për të cilat mund të paraqitet ankesa ndaj aktgjyqimit.

Trajnimi u shoqërua me raste studimi nga praktika gjyqësore sa i përket mjeteve të rregullta të cilat kishin për qëllim që të mbështesnin përfituesit në evitimin e problemeve të cilat shfaqen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin bashkëpunëtorë profesional nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Përgjegjësia penale e personave juridik

Më 20 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Përgjegjësia penale e personave juridik”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimin i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për eliminimin e dilemave që ekzistojnë në praktikë rreth përcaktimit të përgjegjësisë penale të kryesve të veprave penale nga ana e personave përgjegjës të personit juridik dhe të vetë

personave juridik.

Trajnimi u fokusua kryesisht në elaborimin e normave të zbatueshme rreth përgjegjësisë penale të personit juridik, e cila është e lidhur ngushtë me përgjegjësinë e personit përgjegjës, i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve, ka kryer veprë penale me qëllim që personi juridik të realizoj ndonjë dobi, ose ka shkaktuar dëme.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, nga regjionet të ndryshme të Kosovës.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

### **Punëtori për hartimin e testit përfundimtarë për prokurorët e sapoemëruar-PTF VI**

Më 05 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar punëtorinë për hartimin e testit përfundimtarë, për prokurorët e sapoemëruar, të cilët kanë vijuar trajnimin fillestar.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte, hartimi i testit përfundimtarë, të cilit do t'i nënshtrohen prokurorët e sapoemëruar të shtetit, të cilët vijojnë trajnimin fillestar në PTF VI.

Fillimisht, në kuadër të kësaj punëtorie, Drejtori i Akademisë, njoftoi grupin punues lidhur me qëllimin e hartimit të testit përfundimtar, bazën ligjore, strukturën e tij, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me këtë proces. Punimet në kuadër të kësaj punëtorie u

fokusuan në hartimin e pyetjeve dhe rasteve praktike për testin përfundimtar, duke u bazuar në strukturën e testit, të cilën e përcakton Rregullorja për Trajnimin Fillestar.

Në këtë kuadër, janë hartuar pyetjet për secilin modul trajnues, si dhe rastet praktike, për ato module për të cilat parashihen rastet praktike, dhe i gjithë procesi është realizuar bazuar në një sistem konfidencial të të dhënave.

Grupi punues për hartim të testit përfundimtar, është përbërë nga trajnues të Akademisë, të cilët kanë qenë të përfshirë në realizimin e moduleve respektive.



## Aktivitetet e realizuara në PTF për prokurorët e sapo emëruar

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar .

Në kuadër të trajnimit teorik, në këtë periudhë janë realizuar 6 sesione trajnimi, për nën modulet “Kodi i Drejtësisë për të Mitur” “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale”, “Ndërmjetësimi”, Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore –juridike si dhe menaxhimi i rasteve.

Në kuadër të këtyre nën moduleve janë trajtuar: Menaxhimi dhe karakteristikat e tij, planifikimi si funksion kryesor i menaxhimit të rasteve nga ana e prokurorit, dëshmitë, burimet dhe mbledhja e tyre si dhe dosja hetimore,

Dispozitat e përgjithshme që e karakterizojnë procedurën penale ndaj të miturit, ekstradimi, ndërmjetësimi në çështjet penale dhe rëndësia e tij, dhe shpenzimet e procedurës dhe kërkesa

pasurore juridike.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe prokurorët e shtetit kanë ndjekur trajnimin katër ditor “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore” ku janë trajtuar marrja në pyetje dhe udhëheqja e shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë specifike fjala hyrëse, marrja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë në pyetje, vënia në dyshim, rehabilitimi dhe fjala përfundimtare.

Gjithashtu gjatë muajit dhjetor prokurorët e shtetit i janë nënshtruar testit përfundimtarë konform Rregullores për Trajnimin Fillestar.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokuroritë përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.

Këto aktivitete njëherësh shënojnë edhe përfundimin e trajnimit fillestar për prokurorët e shtetit të sapo emëruar të cilët e kanë ndjekur këtë program për 12 muaj.





## Aktivitetet e realizuara në PTF për gjyqtarët e sapoemëruar

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, ka zhvilluar aktivitete në drejtim të përmbushjes së programit trajnuese, duke përfshirë trajnimin teorik, trajnimin praktik si dhe vizitat në institucione jo-gjyqësore.

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përmbushur përmes këtyre aktiviteteve: nën-modulet “Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurën penale (5) sesione trajnuese, “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale” (1) sesion trajnues. “Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit” (4) sesione trajnimi, ”Ekspertiza dhe analiza” (4) sesione trajnuese, dhe ”Kontrolli dhe konfiskimi (4) sesione trajnuese.

Në kuadër të këtyre nën moduleve janë trajtuar thirrja, urdhërarresti dhe premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për paraqitjen më të afërt në stacionin policor dhe dorëzania, arresti shtëpiak, dhe diversioni si dhe paraburgimi. Gjithashtu në kuadër të nën moduleve janë trajtuar masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të urdhëruara nga prokurori i shtetit, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit pas fillimit të procedurës penale, të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohet urdhri për masat e fshehta, kontrollimi

i banesës dhe personit, sekuestrimi i përkohshëm, marrja e pasurisë së përfutur me vepër penale dhe konfiskimi sipas kompetencave të zgjeruara.

Në këtë periudhë po ashtu është realizuar edhe nën moduli “Ekspertiza dhe Analizat” fokusi i të cilit ka qëndruar tek trajtimi i ekspertimit si veprim procedural në procedurë penale, eksperti dhe pozita procedurale e tij, ekspertiza si provë në procedurë penale, dhe ekspertimi dhe analizat sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Metodologjia e aplikuar gjatë realizimit të këtyre sesioneve trajnuese ishte e kombinuar, duke përfshirë ligjërime teorike dhe diskutime interaktive, ku gjyqtarët e sapoemëruar ngritën çështje me interes dhe dilema të cilat po ashtu i vërejnë gjatë fazës praktike të trajnimit në gjykatat përkatëse.

Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, ata u angazhuan në përgatitjen dhe prezantimin e rasteve për situata të ndryshme hipotetike.

Në kuadër të trajnimit praktikë, gjyqtarët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre. Po ashtu, gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë kësaj periudhe, kanë vizituar Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Gjykatën Kushtetuese.



## Trajnimi i gjyqtarëve të sapoemëruar në Institucionin e Avokatit të Popullit

Më 13 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, ka organizuar vizitën me gjyqtarët e sapoemëruar në këtë institucion.

Qëllimi i trajnimit konsistonte në faktin që gjyqtarët e sapoemëruar të formojnë një pasqyrë të qartë rreth mandatit, rolit, strukturës organizative dhe sfidave me të cilat ballafaqohet IAP.

Në kuadër të këtij trajnimi, fillimisht, u pasqyrua një historik i shkurtër i themelimit dhe zhvillimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, korniza ligjore dhe kompetencat e IAP-së sipas legjislacionit të zbatueshëm, mbi të cilin ky institucion ushtron mandatin e tij, si dhe sfidat e përgjithshme me të cilat ata ballafaqohen, duke përfshirë vështirësitë që hasen në bashkëpunimin ndërinstytucional dhe respektimin e rekomandimeve që jep IAP në drejtim të institucioneve publike.

Më tej, u elaborua procedura e brendshme e shqyrtimit të ankesave që paraqiten në IAP, duke përfshirë edhe ankesat e qytetarëve drejtuar ndaj gjyqësorit, puna e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, si dhe relacioni i Institucionit të Avokatit të Popullit me sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë realizimit të këtij trajnimi kishin mundësinë që të jenë interaktiv, duke parashtruar pyetje dhe diskutuar çështje të interesit të përbashkët e që ndërlidhen me punën e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



## Trajnimi i gjyqtarëve të sapoemëruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

Më 20 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, ka realizuar trajnimin me gjyqtarët e sapo emëruar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Trajnimi u realizua me qëllim që gjyqtarët e sapo emëruar të njohohen me rolin, mandatin dhe funksionet e Gjykatës Kushtetuese së Kosovës.

Fillimisht u trajtuan parimet kryesore në bazë të cilave funksionon Gjykata Kushtetuese, struktura dhe raporti i saj me ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin e rregullt. Po ashtu, u shtjellua edhe koncepti dhe zbatimi i kontrollit incidental në Gjykatën Kushtetuese.

Më tej, në mënyrë të hollësishme u elaborua puna praktike e gjykatës, funksionimi i saj i brendshëm, palët e autorizuar, procesi i pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të ndryshme të paraqitura për trajtim para kësaj gjykate si dhe nivelet e vendimmarrjes në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Gjyqtarët e sapoemëruar kishin qasje interaktive, me ç ‘rast patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit dhe që janë në kompetencë të gjykatës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapoemëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



## Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

### Takimi i Këshillit të Redaksisë

Me 11 dhjetor 2017, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i Këshillit të Redaksisë së publikimeve të Akademisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte përcaktimi i punimeve hulumtuese për vlerësim nga secili anëtarë i redaksisë, dhe diskutimi i kriterëve për publikim në revistën “Justicia”, revistë kjo e cila është ekskluzivisht e prokurorëve të sapo emëruar të cilët ndjekin trajnimin fillestar në Akademinë e Drejtësisë.

Në këtë takim u prezantuan punimet e

prokurorëve, si dhe u ndanë temat për redaktim dhe formularët e vlerësimit, të cilat do të integrohen në vlerësimin përfundimtar të prokurorëve në Programin e Trajnimit Fillestar.

Në këtë takim po ashtu u diskutuan edhe çështje tjera nga kompetenca e Këshillit të Redaksisë si dhe u përcaktuan afatet për redaktim dhe dërgim të punimeve për revistën “Justicia”.



## Aktivitetet tjera

### Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë

Prishtinë, 01 dhjetor 2017, në Akademinë e Drejtësisë, u mbajt takimi i shtatë me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.



Më pas, Këshilli Drejtues sipas agjendës shqyrtoi kërkesën e KGJK-së dhe miratoi plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë. Po ashtu Këshilli Drejtues miratoi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar.

Gjatë këtij takimi Këshilli Drejtues themeloi Komisionin për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesave të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit lidhur me vlerësimin e trajnimit fillestar, si dhe miratoi listën e mentorëve për gjyqtarët e sapoemëruar sipas propozimit të KGJK-së.

Në këtë takim Këshilli Drejtues shqyrtoi dhe miratoi Programin e Trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2018.



## Takim i Përbashkët i Grupit Punues për Drejtësinë dhe Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor

Në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), me datë 6-7 dhjetor 2017, është mbajtur takimi i përbashkët i Grupit Punues për Drejtësinë dhe Institucionet e Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor.



Në këtë takim është prezantuar draft raporti me rekomandime për avancimin profesional dhe institucional i Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor, ngritjen e

bashkëpunimit rajonal ndërmjet këtyre institucioneve, si dhe mundësitë për mbështetje nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal.

Në këtë takim ka marrë pjesë Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Valon Kurtaj, Koordinator i Programit z. Besim Morina si dhe z. Lulzim Beqiri, përfaqësues i Kosovës në Grupin Punues për Drejtësi në RCC.

Takimi u përmbyll me konkluzionet që bashkëpunimi i mëtejshëm i përbashkët ndërmjet Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Ballkanit Perëndimor, lehtësuar dhe mbështetur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, si dhe identifikimi i aktiviteteve të ardhshme që do të realizohen si pjesë e këtij rrjeti.



## Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë

Më 06 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme reformës për arsimim ligjor”, ka realizuar punëtorinë e radhës lidhur me “Trajnimin fillestar të bazuar në lëndë - Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë”.

Punëtoria është organizuar me qëllim të diskutimit dhe elaborimit të draft-doracakut të hartuar për trajnimin fillestar të bazuar në lëndë.

Punimet u fokusuan në diskutimin dhe elaborimin e draft-doracakut për trajnim të bazuar në lëndë, struktura e tij dhe rasteve/lëndëve që ai duhet të përmbajë, me qëllim të kompletimit të tij në një format adekuat që shërben si një udhërrëfyes për përgatitjen dhe

realizimin e trajnimeve fillestare duke u bazuar në lëndë.

Në këtë kuadër, ekspertë ndërkombëtarë, prezantuan praktikën e vendeve të ndryshme, lidhur me zhvillimin e mjeteve për hartimin dhe përgatitjen e rasteve mbi bazën e të cilave realizohen trajnimet, organizimin e procesit trajnues dhe çështje të tjera që ndërlidhen me këtë komponent, e të cilat do të mund të përfshiheshin në doracak.

Punëtori të këtij formati do të realizohet dhe në të ardhmen, me qëllim të finalizimit të doracakut për trajnim të bazuar në lëndë.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnues të Akademisë së Drejtësisë, ekspertë të tjerë të angazhuar nga Projekti i Binjakëzimit, dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.



## Punëtorja për finalizimin e PKZMSA-së 2018

Nga data 10-13 dhjetor 2017, nën organizimin e Ministrisë së Integritimit dhe në mbështetje të GIZ, në Durrës është mbajtur punëtorja për finalizimin e PKZMSA-së për vitin 2018, në të cilin kanë marrë pjesë zyrtarë nga institucionet e Republikës së Kosovës.



Qëllimi i kësaj punëtorie ishte rishikimi i draft dokumenteve planifikuese afatshkurtra dhe afatmesme si dhe harmonizimi i tyre me PVPQ, buxhetin, ERA-n dhe dokumentet tjera relevante.

Puna gjatë punëtorisë është zhvilluar në tri grupe të gjëra punuese, përbërja e të cilave ka qenë në bazë të fushave që mbulohen: Kriteret Politike, Kapitulli 23 i Acquis: gjyqësori dhe të drejtat e njeriut, Kapitulli 24 i Acquis: Drejtësia, Liria dhe Siguria.

Me rastin e kësaj punëtorie është bërë verifikimi i planifikimit të institucioneve krahas udhëzimeve relevante për indikatorët, kostimin e masave bazuar me kërkesat e PKZMSA-së si dhe me PVPQ.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin zyrtarë nga Ministria e Integritimit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Akademia e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe institucione tjera që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë.





## Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për Gjyqtarët dhe Prokurorët

Nën organizimin e TAIEX me 12-13 dhjetor 2017, është mbajtur punëtorja “Standardet e BE-së për Trajnimin Fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë”.



Qëllimi i punëtorisë ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve me standardet e BE-së në lidhje me përzgjedhjen dhe trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm, shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave më të mira rreth përzgjedhjes së kandidatëve në programin fillestar.

Me rastin e kësaj punëtorie janë trajtuar standardet e BE-së për trajnimin fillestar, procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, provimet hyrëse, hartimin e moduleve të

trajnimit, si dhe vlerësimin dhe monitorimin e trajnimit fillestar.

Kjo punëtori mundësoi shkëmbimin e praktikave më të mira midis përfaqësuesve të akademive gjyqësore nga vendet e IPA-s dhe ekspertëve të Institutit Belg të Trajnimit Gjyqësor, Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor në Bruksel, gjyqësorit suedez, Qendrës Holandeze të Trajnimit dhe Studimit të Gjyqësorit, Shkollës Kombëtare Franceze të Magjistraturës dhe Shkollës Evropiane të Zbatimit të Bullgarisë.

Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues nga Institucionet e Trajnimit Gjyqësor nga Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Turqia, Serbia dhe Maqedonia.

Akademia e Drejtësisë në këtë takim është përfaqësuar nga: Valon Kurtaj, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, Valmira Pefqeli, Udhëheqëse e Programit të Trajnimit Fillestar dhe Melihate Rama, Udhëheqëse e Divizionit të Programit për Trajnim të Vazhdueshme.



## Punëtori për hartimin e Planit të Punës së Akademisë për vitin 2018

Nga data 15-18 dhjetor 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar një punëtori për “Hartimin e Planit të Punës së Akademisë për vitin 2018”.

Në fokus të kësaj punëtorie ishte hartimi i Planit Vjetor të Punës për vitin 2018, diskutimi i nevojave të Akademisë për një Plan Strategjik si dhe për Rregulloren për Trajnime me fokus te trajnimet e detyrueshme të miratuar nga KGJK.

Pas analizimit dhe diskutimeve të shumta, grupi punues ka përcaktuar strukturën dhe objektivat e secilit program trajnues, prioritetet për periudhën një (1) vjeçare dhe ka përgatitur draftin e programit të punës.

Struktura e programit të punës për vitin 2018, përfshinë misionin dhe vizonin e Akademisë, objektivat strategjike, programin e trajnimeve duke përfshirë programin e trajnimit të vazhdueshëm, programin e trajnimit fillestar, trajnimet për avancim, programin për hulumtime dhe publikime, trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive, trajnimet për stafin administrativ dhe prokurorial, trajnimet për avokatë shtetëror,

avokatë dhe profesione tjera të lira, trajnimet për trajnues, mësimin në distancë, administratën, financat dhe infrastrukturën e Akademisë, bashkëpunimin me partnerët strategjik si dhe planin për zbatimin e programit të punës.

Mbështetur në këtë strukturë dhe prioritete, grupi punues ka hartuar Planin e Punës për vitin 2018, i cili do të miratohet nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

Me rastin e kësaj punëtorie po ashtu është diskutuar edhe drafti i Planit Strategjik të Akademisë së Drejtësisë me qëllim të planifikimit dhe zbatimit të mandatit ligjor në suazat e zhvillimit aktual të burimeve njerëzore të gjyqësorit dhe nevojave për trajnim, trajnimet e detyrueshme si dhe për mundësinë e harmonizimit të këtyre trajnimeve.

Pjesëmarrës ishin Drejtori i Akademisë dhe stafi nga Departamenti i Programit dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.



**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**